



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.159

30 nëntor

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i Kuvendit nr.145, datë 22.11.2007	Mbi dhënien e pëlqimit për emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm.....	4637
Vendim i Kuvendit nr.146, datë 22.11.2007	Për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Shërbimit Civil.....	4637
Vendim i KM nr.764, datë 14.11.2007	Për miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2008, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura.....	4638
Vendim i KM nr.765, datë 14.11.2007	Për hapjen e përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në Lubjanë, Slloveni.....	4639
Vendim i KM nr.766, datë 14.11.2007	Për hapjen e përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në New Dehli, Indi.....	4639
Vendim i KM nr.767, datë 14.11.2007	Për disa shtesa në vendimin nr.718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”	4640
Vendim i KM nr.768, datë 14.11.2007	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pronës nr.185 “Batalioni i vëzhgimit ajror” (ish-reparti ushtarak 3332), Sauk, Tiranë nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”	4642
Vendim i KM nr.769, datë 14.11.2007	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga zgjerimi i varrezave	

	të qytetit, në bashkinë e Pukës.....	4647
Vendim i KM nr.770, datë 14.11.2007	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të komunës Frakull të Qarkut të Fierit	4649
Vendim i KM nr.771, datë 14.11.2007	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Burrel të Qarkut të Dibrës	4650
Vendim i KM nr.772, datë 14.12.2007	Për transferimin në pronësi të bashkisë së Beratit të disa pasurive, truall.....	4652
Vendim i KM nr.775, datë 14.11.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Skavicë”, në lumin Drin i Zi, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.....	4654
Vendim i KM nr.778, datë 14.11.2007	Për miratimin e lejes për ndërtimin dhe shfrytëzimin e linjës tregtare, me rrymë të vazhduar, të interkonjeksionit Seman, (Shqipëri) – Foxhia, (Itali).....	4654
Vendim i KM nr.780, datë 14.11.2007	Për miratimin në parim, të marrëveshjes ndryshuese, për Marrëveshjen e kredisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim IDA, si dhe për Marrëveshjen e grantit të Fondit Ndërkombëtar për Mjedisin (GEF), ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e zhvillimit të burimeve natyrore.....	4655
Vendim i KM nr.782, datë 14.11.2007	Për kalimin e mjediseve të konviktit të shkollës së mesme industriale “Petro Sota”, Fier nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në pronësi të bashkisë Fier të qarkut të Fierit.....	4655
Vendim i KNSH nr.18, datë 1.11.2007	Për skemën ekzistuese, ligjin nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, shfuqizuar me ligjin nr.9734, datë 14. 5. 2007 “Për turizmin”.....	4658
Vendim i KNSH nr.19, datë 1.11.2007	Për skemën ekzistuese, ligjin nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet”, shfuqizuar me ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”.....	4659
Vendim i KNSH nr.20, datë 1.11.2007	Për skemën ekzistuese, ligjin nr.8636, datë 6.7.2000 “Për zonat e lira” amenduar me ligjin nr.9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”.....	4661
Vendim i KNSH nr.21, datë 1.11.2007	Për skemën ekzistuese të pagesës së detyrimeve të prapambetura të ndërmarrjeve me kapital shtetëror.....	4663

Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të vdekur të shtetasit 4664
Algjerim Pilinci.....

Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Kristaq Zarka 4664

VENDIM
Nr.145, datë 22.11.2007

MBI DHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN
E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

Në mbështetje të neneve 78 e 149 pika 1 të Kushtetutës, të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, si dhe të dekretit nr.5526, datë 22.11.2007 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Dhënie e pëlqimit për emërimin e zonjës Ina Rama Prokurore e Përgjithshme.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.146, datë 22.11.2007

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË KOMISIONIT
TË SHËRBIMIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Kostandin Kazanxhi zgjidhet në detyrën e anëtarit të Komisionit të Shërbimit Civil, në vend të zotit Roland Përmeti, të cilit i ka mbaruar mandati.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.764, datë 14.11.2007

PËR MIRATIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2008, TË ENTIT
RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E
PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, nenit 11 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave

të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, për vitin 2008, në shumën 24 095 500 (njëzet e katër milionë e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) lekë, sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ENTI RREGULLATOR I UJIT

Pasqyra nr.1

PROJEKTPLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2008

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Në lekë
1.	Shpenzime për paga	14 776 500
2.	Sigurime shoqërore	3 054 000
3.	Shërbime e furnitura	5 265 000
4.	Investime	1 000 000
	TOTALI	24 095 500

VENDIM

Nr.765, datë 14.11.2007

PËR HAPJEN E PËRFAQËSISË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË LUBJANË, SLLOVENI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në Lubjanë, Slloveni.

2. Shpenzimet për hapjen e kësaj përfaqësie, për muajt nëntor dhe dhjetor në shumën 43 710 (dyzet e tre mijë e shtatëqind e dhjetë) euro, të përballohen nga buxheti i vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.766, datë 14.11.2007

**PËR HAPJEN E PËRFAQËSISË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË
NEW DEHLI, INDI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në New Dehli, Indi.
 2. Shpenzimet për hapjen e kësaj përfaqësie, për muajt nëntor dhe dhjetor në shumën 31 415 (tridhjetë e një mijë e katërqind e pesëmbëdhjetë) euro, të përballohen nga buxheti i vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme.
 3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.767, datë 14.11.2007

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.718, DATË 29.10.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË
TERRORIZMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, e 7 pika 1 të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit “Lista e OKB-së”, që i bashkëlidhet vendimit nr.718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave, të bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në fund të shkronjës “C”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, shtohen personat e renditur në listën “a”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me Al-Qaida”, si anëtarë ose bashkëpunëtorë me Al-Qaida, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues, për talebanët dhe Al-Qaida.

2. Në fund të shkronjës “D”, “Lista e kompanive, që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”, shtohen kompanitë e renditura në listën “b”, “Lista e kompanive, që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”, sipas shtesave në lidhje me listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat dhe kompanitë, që kanë lidhje me talebanët dhe Al-Qaida, si dhe personat, organizatat dhe kompanitë, të cilat rezultojnë si financuese apo që ndihmojnë terroristët dhe organizatat terroriste.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

a. Lista e individeve anetare ose bashkepunetore me Al-Qaida

1. AHMED EL BOUHALI, (i njohur ndryshe si ABU KATADA)
2. FAYCAL BOUGHANEMI (i njohur ndryshe si FAICAL BOUGHANMI)
3. ABDELKADER LAAGOUN,
4. KHADAFI ABUBAKAR JANJALANI
5. SAAD RASHED MOHAMMAD AL-FAQIH
6. ADEL ABDUL JALIL BATTERJEE
7. BAASYIR, ABU BAKAR
8. RIFKI, TAUFIK
9. ANSHORI, ABDULLAH ANSHORI,
10. ABD AL-HAMID SULAIMAN AL-MUJIL
11. ISMAIL MOHAMED ISMAIL ABU SHAWEESH
12. JAMAL HOUSNI
13. NESSIM BEN ROMDHANE SAHRAOUI
14. MERAI ZOGHBAI
15. IBRAHIM MOHAMED KHALIL
16. LOKMAN AMIN MUHAMMED
17. SAJID MOHAMMED BADAT
18. HANI AL-SAYYID AL-SEBAI
19. MAHDHAT MURSI AL-SAYYID UMAR
20. AL-SAYYID AHMED FATHI HUSAYN ALAYWAH
21. ZAKI EZAT ZAKI AHMED
22. ABD ALLAH MOHAMED RAGAB ABDEL RAHMAN.
23. MOHAMMED AHMET SHAWKI AL ISLAMBOLLY
24. ALI SAYYID MUHAMED MUSTAFA BAKRI
25. ISNILON TOTONI HAPILON
26. RADULAN SAHIRON
27. JAINAL ANTEL SALI JR
28. ATA ABDOULAZIZ RASHID.
29. DIEMAN ABDULKADIR IZZAT
30. YASSER MOHAMED ISMAIL ABU SHAWEESH.
31. MAZEN ALI HUSSEIN
32. FARHAD KA BI AHMAD
33. RAFIK MOHAMAD YOUSEF
34. SALEM, NOR ELDIN, AL-DABSKI, ABDULLAH RAGAB
35. SAID, YOUSSEF, ALI, ABU AZIZA, ABDUL HAMID
36. SALEMALY, SOLIMAN, MASSOUD, ABDUL SAYED, MOHAMED OSMAN

b. Lista e kompanive qe i takojne ose bashkepunojne me organizaten Al-Qaeda

- 1.* "IBRAHIM BUISIR" PERFAQESUES I FONDACIONIT IARA NE IRLANDE;
- 2.* "ELEHSSAN";
- 3.* "LASHKAR-E- TAYYIBA";
- 4.* "INTER ISLAMIC RELIEF ORGANIZATION " –IIRO INDONEZI, FILIPINE.;
- 5.* AL-AKHTAR.TRUST.INTERNATIONAL;
- 6.* MISA-MALAYSIAN SWISS, GULF AND AFRICAN CHAMBER.

VENDIM
Nr.768, datë 14.11.2007

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË PRONËS NR.185
“BATALIONI I VËZHGIMIT AJROR” (ISH-REPARTI USHTARAK 3332) SAUK, TIRANË,
NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS DHE PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pronës me numër rendor 185 “Batalioni i vëzhgimit ajror” (ish-reparti ushtarak 3332) Sauk, Tiranë, sipas vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për sigurimin e mjediseve shtesë për veprimtarinë e institucioneve të arsimit të lartë.

2. Prona me numër rendor 185, “Batalioni i vëzhgimit ajror” (ish-reparti ushtarak 3332) Sauk, Tiranë, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe Kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE
(Per inventarizimin e pronave si klasa te vecanta)


Komuna Farkë, Tiranë										
A			B			C				
Nr	Zona Kadas Indeksi i hartes	Numeri pasuris	Emertesa e pronës Vendodhja/ shtrirja Gjeografike	Komponentet perberes te pronës	Adresa/ vendodhja e komponenteve perberes	Permasat e Pronës ne M2 ose MI	Funksioni per te cilin perdoret prona	Enti me Pergjegjesi Administrative	Enti Perdorues Statusi Jundik i perdorimit	Te dhena te tjera shenime te vecanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
185			Repart Ushtarak Nr. 3020			24200 M2	Per Mbrotjten	MM Rep.Usht. 3400 Tiranë	Rep.Usht. 3020 Tiranë	
			Sauk Tiranë	Zyrat e komandes	Sauk Tiranë	275				
				Trup roje		40				
				Oficena		360				
				Depo materjalesh		192				
				Depo materjalesh		192				
				Park 8 vendesh		216				
				Depo municioni		91				
				Depo materjalesh		40				
				Depo menxhe guzhine		68				
				Zdrukturia		40				
				Depo karburanti		50				
				n/hokscore						
				Wc		12				
				Rruge te brendeshme		200				
				Linje ujeshjellesi		160 ml				
				Truall		22474				

PLANIMETRIA E OBJEKTIT NR.1 KOMANDA KATI PERDHE
 SHKALLA 1/100
 SIPERFAQJA 211.4 m²



MINISTRIA E MBRODITISE
 MINISTRIA E BEGJEVESE
 DOKUMENTI

SUPERFAQJA 211.4 m2



REP SHQIPERISE MIN. MBROTJES I.G.U.	DREJTORI	DR MYSLIR. HAJHA	<i>[Signature]</i>
	VIZATOI	N.TOGA BEI	<i>[Signature]</i>
REP USHT Nr 3322 SAUK	PERPILLOI	Top SULEJFA	<i>[Signature]</i>
	KONTROLLOI	Ing. K. HYSEMI	<i>[Signature]</i>

VENDIM
Nr.769, datë 14.11.2007

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA ZGJERIMI I VARREZAVE TË
QYTETIT, NË BASHKINË E PUKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga zgjerimi i varrezave të qytetit, në bashkinë e Pukës.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Pukës.
 3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 2250 m² tokë/arë, vlerësuar me çmimin 320 lekë/m², me vlerë të përgjithshme 712 000 (shtatëqind e dymbëdhjetë mijë) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Pukës.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga bashkia e Pukës.
 6. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë data 30.11.2007.
 7. Afati i përfundimit të punimeve për objektin “Zgjerimi i varrezave publike të qytetit”, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Pukës, për realizimin e këtij projekti.
 8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 2 250 m² tokë/arë, shpronësuar në favor të bashkisë së Pukës, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe kryetari i bashkisë së Pukës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA PUKE

Puke, me 15.06. 2007

Lista e pronareve te pasurise prone private per te cilet kerkohet shpronnesimi I tokes truall per varrezat e qytetit Puke

Ministrise se Brendshme

TIRANE

Nr	PRONARI	Adresa e Pronareve	Sip. Tokes per Shpronnesim ne m ²	Çmimi Tokes m ² /Leke	Vlera Tokes Per Shpronnesim ne Leke
1.	Halil Mus Laçi	Lagje Laçaj, Bashkia Puke	1155	320	369 600
2	Sherif Osman Laçi	Lagje Laçaj, Bashkia Puke	892	320	285 440
3	Hamit Kapllan Laçi	Lagje Laçaj, Bashkia Puke	178	320	56 960
	SHUMA		2225	320	712 000

V.O. – Pronare, pasurite private te te cileve zhvleresohen per shkak te shpronnesimit te tokes per varrezat e qytetit , nuk ka.

- Pronare te trete qe duhet te kompesohen per shkak te shpronnesimit te tokes per varrezat e qytetit nuk ka.



VENDIM
Nr.770, datë 14.11.2007

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË
KOMUNËS FRAKULL TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Frakull të qarkut të Fierit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 50 (pesëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 285 (dyqind e tetëdhjetë e pesë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Frakull për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
27-42	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
43-57	Varrezat publike	Në pronësi
1-14	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
15-20	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
21-26	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social- kulturore e sportive.	Në pronësi
148,152,158,160,161,165	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
149,150,151,153,154,155, 156,157,159,162,163,164, 212,216,226,231,233,235, 237,239,242,246,251,255, 256	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive)	Në Pronësi
58-69	Prona që përdoren mbrojtjen civile.	Në pronësi
166-189,190-207	Infrastruktura (rrugë vendore, lulishte) dhe shërbime publike.	Në pronësi

VENDIM**Nr.771, datë 14.11.2007**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE SHETETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË
BASHKISË BURREL TË QARKUT TË DIBRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shetetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Burrel të qarkut të Dibrës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është

pjesë përbërëse e tij.

Lista me 78 (shtatëdhjetë e tetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 482 (katërqind e tetëdhjetë e dy).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Burrelit për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Burrel

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
14-20;22;23;26;27;28;	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
34-49;	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
100-105;	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve sociale.	Në pronësi
142;	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
143-151;185;186-379;384-389;415-427;428-452;453-482;	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, sheshe) dhe shërbime publike.	Në pronësi
86-99;	Prona që përdoren në fushën e kulturës dhe sportit.	Në pronësi
106;107;	Varrezat publike.	Në pronësi
152-184;	Infrastrukturë (troje)	Në përdorim
54;55;60-79;	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik, dhe bujqësisë e ushqimit.	Në pronësi
111-122;383;	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile	Në pronësi

VENDIM
Nr.772, datë 14.11.2007

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË BERATIT TË DISA PASURIVE,
TRUALL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 shkronja “k”, 5, 8 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të bashkisë së Beratit të pasurive me numrat rendorë 440, 441, 442 e 443 dhe me sipërfaqe përkatëse 1 473 m², 943 m², 2 455 m² e 2 233 m², sipas listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Beratit, për ngritjen e banesave sociale.

2. Bashkisë së Beratit i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, t’i tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe kryetari i bashkisë së Beratit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)



1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
439	8501 E-3.2	7/2	Truall	Truall Lagja Çlirim Bashkia Berat	2677	-	Shesh	Bashkia Berat	Bashkia Berat
440	E-3.2	7/4	Truall	Truall Lagja Barrikade Bashkia Berat	1473	-	Shesh	Bashkia Berat	Bashkia Berat
441	E-2	7/5	Truall	Truall Lagja Barrikade Bashkia Berat	943	-	Shesh	Bashkia Berat	Bashkia Berat
442	E-2	7/7	Truall	Truall Lagja Barrikade Bashkia Berat	2455	-	Shesh	Bashkia Berat	Bashkia Berat
443	E-2	7/8	Truall	Truall Lagja Barrikade Bashkia Berat	2233	-	Shesh	Bashkia Berat	Bashkia Berat
444	C-2	7/9	Truall	Truall Lagja Barrikade Bashkia Berat	1008	-	Shesh	Bashkia Berat	Bashkia Berat
445	E-2	7/11	Truall	Truall Lagja Barrikade Bashkia Berat	947	-	Shesh	Bashkia Berat	Bashkia Berat
446	E-2	7/17	Truall	Truall Lagja Barrikade Bashkia Berat	155	-	Shesh	Bashkia Berat	Bashkia Berat

VENDIM
Nr.775, datë 14.11.2007

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “SKAVICË”, NË LUMIN DRIN I ZI DHE
MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I
JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Skavicë”, në lumin Drin i Zi, nga kuota 441-285 m mbi nivelin e detit, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 10 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “TGK Skavica Srl”.

3. Vendimi nr.299, datë 6.5.2005 i Këshillit të Ministrave “Për fillimin e procedurës së ndërtimit me koncesion të formës “BOT”, për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës, sipas propozimit të pakërkuar”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.778, datë 14.11.2007

**PËR MIRATIMIN E LEJES PËR NDËRTIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E LINJËS
TREGTARE, ME RRYMË TË VAZHDUAR, TË INTERKONJEKSIONIT SEMAN,
(SHQIPËRI) – FOXHIA, (ITALI)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 31, pika 1, dhe 31/1 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të linjës tregtare, me rrymë të vazhduar, të interkonjeksionit Seman, (Shqipëri) – Foxhia, (Itali).

2. Miratimin e lejes nr.1, datë 13.11.2007, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e linjës tregtare, me rrymë të vazhduar, të interkonjeksionit Seman, (Shqipëri) – Foxhia, (Itali), leje e lëshuar nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shoqërisë “ASG Power Albania” sh.a., sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.780, datë 14.11.2007

**PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES NDRYSHUESE, PËR
MARRËVESHJEN E KREDISË, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM
(IDA), SI DHE PËR MARRËVESHJEN E GRANTIT TË FONDIT NDËRKOMBËTAR PËR
MJEDISIN (GEF), NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM,
PËR PROJEKTIN E ZHVILLIMIT TË BURIMEVE NATYRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes ndryshuese, për Marrëveshjen e kredisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), si dhe për Marrëveshjen e grantit të Fondit Ndërkombëtar për Mjedisin (GEF), ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e zhvillimit të burimeve natyrore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.782, datë 14.11.2007

**PËR KALIMIN E MJEDISEVE TË KONVIKTIT TË SHKOLLËS SË MESME
INDUSTRIALE “PETRO SOTA”, FIER, NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
NË PRONËSI TË BASHKISË FIER TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10, 11 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5 e 6 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e mjediseve të konviktit të shkollës së mesme industriale “Petro Sota”, Fier, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në pronësi të bashkisë Fier të qarkut të Fierit, sipas formularit dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, kryetari i bashkisë së Fierit dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Formulari i Inventarizimit te ish konviktit te shkolles industriale "Petro Sota " Fier

Nr	Zona kadastrale dhe indeks hartes	Nr Pasurise	Lloji i prones	Emri i prones, Adresa	Sip. totale m2	Nga sip. totale, sa ndertese m2	Funkcioni per te cilin perdoret prona	Institucioni/ enti me pergjegjesi administrative	Te dhena te tjera
21	8534 L,M-4,5 (4- 5)	4/40	Truall, ndertese	Ish konvikt i shkolles industriale "Petro Sota"	692	692	Banese	M.A.SH D.Arsimore Bashkia Fier	Zene nga te pastrehet

Pergjegjes i Zyres Iventarizimit te Pronave Publike
Et'hem Guma



FR) L1M 415

PLAN VENDOŠJA E^{1st} KONVIKTIT TE JHKOLLES SE MECHC
PGTPO SOFA "FIED
SHK 1:500

4/39

4/59

4/40

PUNOJ
C N. GUKO)
R.P.

VENDIM
Nr.18, datë 1.11.2007

PËR SKEMËN EKZISTUESE, LIGJIN NR.7665, DATË 21.1.1993 “PËR ZHVILLIMIN E ZONAVE QË KANË PËRPARËSI TURIZMIN”, SHFUQIZUAR ME LIGJIN NR.9734, DATË 14. 5. 2007 “PËR TURIZMIN”

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

Z.Genc Ruli	- kryetar
Znj.Mimoza Dhëmbi	- anëtare
Z.Viktor Gumi	- anëtar
Z.Ledi Bianku	- anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 1.11.2007, shqyrtoi raportin “Për skemën ekzistuese “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin””, të ndryshuar me ligjin nr.9734, datë 14.05.2007 “Për turizmin”. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr. AI/004/2005.

BAZA LIGJORE: Si bazë për dhënien e ndihmës ka qenë ligji nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, i shfuqizuar me ligjin nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”.

OBJEKTIVI/AT: Skema ka si qëllim nxitjen e investimeve në sektorin e turizmit, nëpërmjet përjashtimeve të ndryshme nga taksat, si dhe dhënies së garancive nga ana e shtetit për subjektet që ushtrojnë veprimtarinë në këtë sektor.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Ndihmës Shtetërore dhe të gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Skema fillestare përfshinte personat e stimuluar, të cilët sipas ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, kishin të drejtën të përjashtoheshin nga taksat e detyrimet doganore, si dhe të kundërbalanconin humbjet e pësuar gjatë 5 viteve të para të zhvillimit të veprimtarisë.

2. Lejet e dhëna në bazë të atij ligji, janë aplikuar jo vetëm për zhvillimet e lidhura me turizmin, por edhe për forma të tjera zhvillimi brenda zonës, që kanë prekur qëllimin dhe theksin turistik të tyre.

3. Megjithëse në ligjin nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin” jepej e drejta e lidhjes së marrëveshjes për qiranë e tokës, në të nuk përcaktoheshin strukturat e menaxhimit dhe kontrollit, si dhe nuk krijoheshin lidhje me kriteret dhe standardet e pritshme të zhvillimit.

4. Ndryshe nga ligji i vjetër, që përmbante në vetvete skema të drejtpërdrejta të ndihmës shtetërore për sektorin e turizmit, ligji i ri nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”, parashikon në formë të përgjithshme mekanizmat e mbështetjes financiare.

5. Ligji i ri parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore për procedurat që duhen ndjekur për dhënien apo monitorimin e skemave mbështetëse për këtë sektor.

6. Ai ngarkon Agjencinë Kombëtare të Turizmit për hartimin e programeve financiare për mbështetjen e turizmit dhe ndjekjen e të gjitha procedurave për dhënien dhe menaxhimin e asistencës financiare për ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e turizmit.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 13, pika 3, nenit 23 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, si dhe nenit 19 të rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.817, datë 28.12.2005,

VENDOSI:

1. Të konsiderojë në përputhje me dispozitat e legjislacionit të ndihmës shtetërore në fuqi ligjin nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin” që ka shfuqizuar skemën ekzistuese të ndihmës shtetërore, ligjin nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”.

2. Të gjitha organet shtetërore që, në bazë të nenit 19 të ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”, ndihmojnë zhvillimin e turizmit duke propozuar politika të lehtësive fiskale për bizneset turistike, për individët dhe subjektet juridike, janë të detyruara që, për çdo plan skeme ndihme apo ndihme të re individuale, të ndjekin të gjitha procedurat e parashikuara në legjislacionin e ndihmës shtetërore.

3. Agjencia Kombëtare e Turizmit dhe organet e tjera shtetërore, brenda datës 31 mars të çdo viti, të raportojnë pranë DNSH-së për të dhënat e zbatimit të skemave të ndihmës dhe çdo ndihme individuale gjatë vitit paraardhës financiar në kuadër të ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”.

4. Agjencia Kombëtare e Turizmit të ruajë të dhënat për skemat e ndihmës dhe ndihmat individuale të përfituara në bazë të ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin” deri pas 10 vjetësh nga data e dhënies së fundit të asistencës financiare në kuadër të zbatimit të këtij ligji.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Genc Ruli**

VENDIM

Nr.19, datë 1.11.2007

PËR SKEMËN EKZISTUESE, LIGJIN NR.7973, DATË 26.7.1995 “PËR KONCESIONET”, SHFUQIZUAR ME LIGJIN NR.9663, DATË 18.12.2006 “PËR KONCESIONET”

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

Z.Genc Ruli	- kryetar
Znj.Mimoza Dhëmbi	- anëtare
Z.Viktor Gumi	- anëtar
Z.Ledi Bianku	- anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 1.11.2007, shqyrtoi raportin “Për skemën ekzistuese “Për koncesionet””, të ndryshuar me skemën “Për koncesionet”, të vitit 2006. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore nga Drejtoria e Licencave dhe Menaxhimit të Kontratave në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.AL/003/2005.

BAZA LIGJORE: Si bazë për dhënien e ndihmës ka qenë ligji nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet”, i shfuqizuar me ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”.

OBJEKTIVI/AT: Skema kishte si qëllim nxitjen e investimeve nëpërmjet zhvillimit të veprimtarisë prodhuese dhe të shërbimit, në sektorë, të tillë si: industria e kromit, prodhimi i energjisë elektrike me hidrocentralet lokale, disa ujësjellës etj., nëpërmjet marrëveshjeve koncesionare të formave të ndryshme, duke dhënë mbështetje shtetërore për kompanitë koncesionare, të tilla si: përjashtimin nga tatimi mbi fitimin, tarifatat doganore, taksat e qarkullimit, taksat e importit, sigurimin e pasurive a shërbimeve të tilla si toka, pajisjet, lënda djegëse, transport urban për punonjësit, mbledhje e mbeturinave, mbrojtjen nga ndërprerja e kontratës për shkak të një force madhore, mbrojtje nga ndryshimi i taksave ose tarifave doganore, indeksimin e çmimeve në bazë të një indeksi të caktuar, si për shembull indeksi i çmimeve të mallrave të konsumit, garantimin e konvertimit të monedhës vendase në valutë, kur është e nevojshme edhe me garanci bankare, garantimin ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit të valutës, garantimin e bashkëpunimit me organet e duhura shtetërore, garantimin e

transferimit të fitimit,garantimin e një niveli të caktuar kërkesë tregu për mallrat ose shërbimet e projektit, reduktimi i taksave me miratim nga Parlamenti.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Ndhmës Shtetërore dhe të gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Në bazë të skemës fillestare, ishin lidhur disa marrëveshje koncesionare për zhvillimin e veprimtarisë prodhuese dhe të shërbimit, si: në industrinë e kromit, prodhimin e energjisë elektrike me hidrocentralet lokale, disa ujësjellës etj.

2. Për marrëveshjet koncesionare, kontratat e miratuara ishin kryesisht sipas metodës me ofertë të pakërkuar, ndërsa investitorët privatë ishin, kryesisht, të huaj.

3. Nga kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të kontratave koncesionare të lidhura, si në industrinë e kromit, ashtu dhe në atë të energjisë elektrike, rezultoi se investimet nuk ishin realizuar në nivelin që ishte parashikuar në projektet e miratuara. Gjithashtu niveli i investimeve të realizuara ka pasur tendencë në ulje nga vitit në vit.

4. Nuk ka pasur të dhëna të sakta për impaktin e pritshëm nga dhënia me koncesion e HEC-eve, përqindjen e nevojave për energji që parashikohet të mbulojnë ato, impaktin që sjellin në zhvillimin e zonave të thella malore, investimet apo të ardhurat që do të realizoheshin prej tyre, si dhe treguesit e tjerë të lidhur me to, si punësimi etj.

5. Në pjesën më të madhe të marrëveshjeve nuk ka pasur të parashikuara sanksione në rast të mospërbushjes së detyrimeve nga ana e koncesionarëve. Edhe në rast kur sanksionet kanë qenë të parashikuara në kontratat koncesionare, nga ana e autoriteteve shtetërore nuk është kërkuar zbatimi i tyre.

6. Në ligjin e ri nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, si procedurë bazë për përzgjedhjen e koncesionarit, si për ofertën e kërkuar, ashtu dhe për atë të pakërkuar, është përcaktuar procedura konkurruese. Negocimi i drejtpërdrejtë është parashikuar të aplikohet vetëm për raste të veçanta dhe me miratim të Këshillit të Ministrave.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të nenit 13, pika 3, nenit 23 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, si dhe nenit 19 të rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.817, datë 28.12.2005,

VENDOSI:

1. Në rastet kur kontratat koncesionare lidhen në bazë të metodës së negocimit, përpara lidhjes së kontratës duhet të merret miratimi i Komisionit të Ndhmës Shtetërore.

2. Për asetet që jepen nën çmimin e tregut, të bëhet llogaritja e vlerës reale të tyre nga ekspertë të pavarur dhe, mbi këtë bazë, të llogaritet kontributi i përfituesit për financimin e investimit fillestar, i cili duhet të jetë të paktën në masën 25%. Nëse për lidhjen e kontratave koncesionare për vënien në përdorim të këtyre aseteve, nuk ndiqen procedurat e tenderit të hapur, për çdo rast duhet të merret miratimi paraprak i Komisionit të Ndhmës Shtetërore.

3. Drejtoria e licencave dhe menaxhimit të kontratave në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, brenda datës 31 mars të çdo viti të raportojë pranë DNSH-së për të dhënat e zbatimit të skemave të ndihmës dhe çdo ndihme individuale në kuadër të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet” gjatë vitit paraardhës financiar.

4. Drejtoria e Licencave dhe Menaxhimit të kontratave në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, të ruajë të dhënat për skemat e ndihmës dhe ndihmat individuale deri pas 10 vjetësh nga data e përfundimit të marrëveshjes së fundit koncesionare në kuadër të zbatimit të këtij ligji.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli

VENDIM
Nr.20, datë 1.11.2007

PËR SKEMËN EKZISTUESE LIGJIN NR.8636, DATË 6.7.2000 “PËR ZONAT E LIRA”
AMENDUAR ME LIGJIN NR.9789, DATË 19.7.2007 “PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E ZONAVE EKONOMIKE”

Komisioni i Ndhmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

Z.Genc Ruli	- kryetar
Znj.Mimoza Dhëmbi	- anëtare
Z.Viktor Gumi	- anëtar
Z.Ledi Bianku	- anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 1.11.2007, shqyrtoi raportin “Për skemën ekzistuese “Për zonat e lira””, të ndryshuar me ligjin “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndhmës Shtetërore nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Tregtare në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.AL/007/2005.

BAZA LIGJORE: Si bazë për dhënien e ndihmës ka qenë ligji nr.8636, datë 6.7.2000 “Për zonat e lira”, i shfuqizuar me ligjin e ri nr.9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”.

OBJEKTIVI/AT: Skema ka si qëllim shfrytëzimin e burimeve e potencialeve në nivel lokal e kombëtar, rritjen e fuqisë konkurruese të bizneseve dhe pjesëmarrjen e tyre aktive në tregtinë ndërkombëtare, rritjen e nivelit të prodhimit, eksporteve, shërbimeve e punësimit, nxitjen e investimeve dhe transferimin e teknologjive të avancuara.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Ndhmës Shtetërore dhe të gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Skema fillestare, në parim, mbulonte mallrat e importuara si të përjashtuara nga detyrimet doganore, nga taksat e importit dhe lloje të tjera të kontrollit të importit, të cilat, në bazë të legjislacionit doganor të vendit tonë, gjejnë zbatim për mallrat që importohen në zona të tjera të vendit.

2. Neni 18 i ligjit nr.8636, datë 6.7.2000 “Për zonat e lira”, përmbante disa elemente të ndihmës shtetërore, që lidheshin me: përjashtimin nga detyrimet doganore, përjashtimi nga TVSH-ja, si dhe përjashtimi nga tatimi mbi fitimin për subjektet e licencuara, në 10 vitet e para të veprimtarisë së tyre në zonën e lirë.

3. Pavarësisht lehtësirave të dhëna, gjatë të gjithë periudhës që ka qenë në fuqi ligji nr.8636, datë 6.7.2000 “Për zonat e lira”, nuk ka pasur asnjë rast konkret të zbatimit të skemës.

4. Në ligjin e ri, nr.9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”, vazhdon të mbetet në fuqi përjashtimi nga detyrimet doganore dhe përjashtimi nga tatimi mbi vlerën e shtuar. Skema e re nuk përmban elementet e ndihmës në formën e përjashtimit nga tatimi mbi fitimin për 10 vitet e para të veprimtarisë.

5. Në ligjin e ri nuk është parashikuar ndonjë referencë në dispozitat e ligjit të ndihmës shtetërore për miratimin e zonave të lira apo të investimeve të veçanta në to.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të nenit 13, pika 3, nenit 23 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, si dhe nenit 19 të rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.817, datë 28.12.2005,

VENDOSI:

1. Në rregulloren për funksionimin e zonave ekonomike, që duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave, në bazë të nenit 8 të ligjit nr.9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike” të përcaktohet që për çdo rast të caktimit të zonës ekonomike, apo ndonjë veprimtarie të veçantë në të, në formën e ndihmës individuale, të merret miratimi paraprak nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin e ndihmës shtetërore.

2. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë në zonën e lirë duhet të jepet në bazë të kriterëve objektive dhe transparente.

3. Në llogaritjen e intensitetit të ndihmës në kuadër të skemave apo në formën e ndihmave individuale nga zbatimi i këtij ligji, të merren parasysh të gjitha format e ndihmave që ndërmarrjet kanë përfituar apo mund të përfitojnë nga burime të tjera shtetërore.

4. Në rregullore të përcaktohen edhe sanksionet që zbatohen për ndërmarrjet në rast të mospërbushjes së angazhimeve të tyre për investime, punësim apo të gjitha kontributet e tjera, të përcaktuara në licencën për ushtrimin e veprimtarisë në zonën e ekonomike.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Tregtare brenda datës 31 mars të çdo viti të raportojë pranë DNSH-së për impaktin e investimeve dhe realizimin e të gjithë treguesve të tjerë gjatë vitit paraardhës financiar, të parashikuara në licencat përkatëse për ndërmarrjet që përfitojnë në kuadër të skemave apo në formë të ndihmës individuale nga dispozitat e ligjit nr.9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”.

6. Të dhënat për ndërmarrjet që përfitojnë nga skemat e ndihmës apo ndihmat individuale, si rezultat i zbatimit të ligjit nr.9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”, të ruhen deri 10 vjet nga data e dhënies së licencës së fundit në kuadër të zbatimit të këtij ligji.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli

VENDIM
Nr.21, datë 1.11.2007

PËR SKEMËN EKZISTUESE TË PAGESËS SË DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË NDËRMARRJEVE ME KAPITAL SHTETËROR

Komisioni i Ndhmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

Z.Genc Ruli	- kryetar
Znj.Mimoza Dhëmbi	- anëtare
Z.Viktor Gumi	- anëtar
Z.Ledi Bianku	- anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 1.11.2007, shqyrtoi raportin “Për skemën ekzistuese të pagesës së detyrimeve të prapambetura të ndërmarrjeve me kapital shtetëror”. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndhmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.AL/014/2005.

BAZA LIGJORE: Si bazë për dhënien e fondeve për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura ka qenë ligji nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, ligji nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.711, datë 18.10.2006 “Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve në pronësi të njërive të qeverisjes vendore”.

OBJEKTIVI/AT: Skema synon të përmirësojë dhe të shëndoshë situatën financiare të ndërmarrjeve me kapital shtetëror, duke normalizuar llogaritë e tyre, nëpërmjet mekanizmit të pagesës së detyrimeve të prapambetura dhe të ndërsjella.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Ndhmës

Shtetërore dhe gjithë të dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Skema mbulon kryesisht sektorin e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve, duke synuar zvogëlimin e shumës së detyrimeve të prapambetura të kontabilizuara në pasqyrat e gjendjes pasurore për secilën ndërmarrje.

2. Masa klasifikohet si një ndihmë operationale që jepet për të lehtësuar veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve përfituese, nëpërmjet reduktimit të një pjese të shumës së detyrimeve të akumuluar. Megjithatë, mbështetja mund të justifikohet për shkak të natyrës së saj, pasi furnizimi me ujë të pijshëm konsiderohet një shërbim me interes publik.

3. Ndërmarrjet e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve kanë akumuluar në vite shuma të mëdha detyrimesh ndaj KESH sh.a.-së. Shkak për këtë situatë ka qenë menaxhimi i dobët i veprimtarisë së tyre ekonomike në drejtim të humbjeve teknike në rrjet si pasojë e rrjetit të amortizuar, faturimit të prodhimit dhe arkëtimit të të ardhurave nga faturimet, si dhe detyrimi për ofrimin e shërbimit publik, duke mos orientuar çmimet drejt kostos.

4. Skema ka filluar të zbatohet që nga viti 2002 dhe fondet e vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit për këtë qëllim kanë qenë në rënie nga viti në vit.

5. Për vitet 2005 dhe 2006, intensiteti i ndihmës në kuadër të skemës së shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, për ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve llogaritet në 24,8 %. Duke e akumuluar vlerën e ndihmës për këto ndërmarrje edhe me përfitimet që kanë marrë edhe nga skema e subvencionimit të drejtpërdrejtë, intensiteti arrin në masën 39,6 %.

6. Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.660, datë 12.9.2007 aksionet e ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve u transferohen njësisë të qeverisjes vendore dhe detyrimet e prapambetura të tyre, deri në çastin e transferimit, do të shlyhen nga Buxheti i Shtetit, duke zhveshur bilancet e shoqërive nga ato detyrime përpara se të kryhet transferimi i aksioneve.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, mbështetur në nenin 13, shkronja “c”, nenin 15, pikat 2 dhe 3, nenin 23 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, në nenin 7 të rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.815, datë 28.12.2005, si dhe në nenet 19 dhe 21 të rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.817, datë 28.12.2005,

VENDOSI:

1. Të konsiderojë skemën në përputhje me kriteret e legjislacionit të ndihmës shtetërore.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve të raportojë pranë DNSH-së për ecurinë e zbatimit të skemës deri në afatin e transferimit të ndërmarrjes së fundit drejt pushtetit vendor.

3. Ministria e Punëve të Brendshme të raportojë, brenda datës 31 mars të vitit 2008, pranë DNSH-së për vlerën totale të ndihmës së dhënë ndërmarrjeve të ujësjellësve, në kuadër të skemës, gjatë vitit 2007.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr.2430, datë 22.10.2007, shpall si të vdekur më datë 31.12.1999, shtetasin Algjerim Pilinci, i datëlindjes 8.8.1961, lindur dhe banues në Podgorije.

KËRKESË

Shtetasi Markeljan Zarka, i biri i Kristaqit dhe i Vangjelisë, i datëlindjes 1980, banues në Dorëzezë, Fier, kërkon shpalljen të vdekur të babait të tij Kristaq Zarka.

KËRKUESI
Markeljan Zarka

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. REGJISTRAT E NOTERISË
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PUNËS

KODI I FAMILJES

PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat

Hyri në shtyp më 27.11.2007
Doli nga shtypi më 30.11.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2007

Çmimi 32 lekë